

STATUTI  
I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR  
“**Innovative Marketing Idea**”

Sot me date 14/01/2022 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “**Innovative Marketing Idea**”, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zotërohet nga ortaku:

Amir Memaj, i datëlindjes 26/06/1979 shtetas shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Shkoder, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal H90626101R.

I cili në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë miratojnë statutin e shoqërisë “**Innovative Marketing Idea**”, në bazë të parimeve të mëposhtme:

**KAPITULLI I**  
**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,**  
**SELIA, TERRITORI**

NENI 1  
FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “**Innovative Marketing Idea**”, forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.



---

## NENI 2 BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

## NENI 3 SELIA

Selia e shoqërisë është në adresën: Tiranë, Tiranë, TIRANË Lagjia Selitë , Rruga Medar Shtylla , Kati 10 , Apt 8 Zona Kadastrale Nr 3292 Numër Pas 100/11+1 .

Me adresën e mësipërmë do të identifikohët qendra e personit juridik. Me vendim të asamblesë së ortakëve mund të hapën degë, filialë, agjensi ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushavë në të cilat ë ushtron veprimtarinë shoqëria.

## NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra, filialë osë përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të krijohën dhe do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## **KAPITULLI II** **OBJEKTI DHË KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

## NENI 5 OBJEKTI I VËPRIMTARISË

5.1 Shoqëria "**Innovative Marketing Idea**", është e organizuar në formën e një shoqërie të prodhimit dhe tregtimit në të gjithë komponentët e saj dhe ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

Prodhimi, shitja dhe asistenca e software dhe rrjeteve informatike, mbajtja, riparimi dhe marrja me qira e pajisjeve dhe mjeteve elektronike per perpunimin e te dhenave; menaxhimi i qendrave te perpunimit te te dhenave dhe te rrjeteve informatike te cdo lloji; menaxhimin e kurseve per informatike dhe organizim te ndermarrjes; tregëtim me shumicë dhe pakicë, përfshirë atë elektronik, te pajisjeve dhe objekteve,

---



hardware, aksesorët e tyre, mobilje dhe pajisjet per zyra, software, me dhe pa depozite per shitjen e software, rrjeteve informatike, hardware dhe objekteve ne pergjithesi per perpunimin e te dhenave si dhe sherbimeve te lidhura me to. Zhvillim software, platforma dixhitale, ecommerce.

Lidhur me aktivitetin e permendur me siper, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, mbetet e kuptuar se detyra te tilla profesionale do t'i ngarkohen drejteperdrejt profesionisteve, rregullisht te aktivizuar ne varesi te rastit, nen pergjegjesine e tyre. Shoqeria mund te punesoje dhe te pranoje agjenci, komisione, perfaqesim dhe mandatim. Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve te internetit, ofrim domain-esh, sherbime web hosting, sherbimeve te telekomunikacionit, pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale ne internet si dhe marketing online, mirembajtja dhe riparimi I kompjuterave dhe rrjeteve te komunikimit si dhe sherbime te tjera informatike. Hartim dhe implementim projektesh ne fushen e teknologjise se informacionit. Zhvillim. software, platforma dixhitale, ecommerce dhe shitja e programeve kompjuterike per perdorim ne fusha te ndryshme. Ofrimi I sherbimeve te ndryshme informatike ne fushen e teknologjise se informacionit. Sherbime marketing ne fushen e monitorimit te medias elektronike dhe te shkruar, perpunime statistikore, Publikime, dhenie informacioni online, media te shkruara, media audio-vizive, sherbime ne fushen e perkthimit etj. Konsulenca ne lidhje me aplikimin e teknologjise se informacionit ne fusha te ndryshme.

Importimi dhe shitja e hardware-ve per perdorim ne fushen e teknologjise se informacionit. Shoqeria do te kryeje pa kufizim cdo aktivitet tjetër te lejueshem nga legjislacioni ne fuqi edhe pse jo i permendur ne kete akt. Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga Asambleja e Ortakëve .

## NENI 6 KOHËZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të asamblesë së ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

## KAPITULLI III

### **LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTËT E DISTINUARA PËR TË TRËTËT**

---



NENI 7  
LIBRI I SHOQËRISË

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomikë si dhe marrëdhëniët e punës, shoqëria do të çele librin e vet, i cili do të quhet libri i shoqërisë.

NENI 8  
KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimët që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 9  
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretet, si letrat, faturat, lajmerimët dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri më Përgjegjësi të Kufizuar” osë inicialët “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose të administratorëve.

**KAPITULLI IV**

**KAPITALI THËMËLTAR, KONTRIBUTËT, PJËSËT DHË TRANSFERIMI  
I TYRË**

NENI 10  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është : 100,000 Lëk ( Njëqindmijë lek), zotëruës i një kuotë më 100% të aksioneve.

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

NENI 11  
TË DREJTAT Ë ORTAKËVË NË LIDHJE ME KAPITALIN

11.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, më shumicën e (tre të katërtavë) të kuotavë

---



të kapitalit themeltar të shoqërisë.

11.2 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

11.3 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotavë të kapitalit themeltar të shoqërisë për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përbarimorë ose ndonje organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsideratë respektimin e kërkesave të nenit 14 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin të shpjëgojë nenin 14 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguruese.

11.4 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

11.5 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabël e dokumentët e tjera që lidhen me administrimin e saj.

## NENI 12 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

## NENI 13 FINANCIMI I SHOQËRISË

13.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjorë në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.


13.2 Financimët e mëtëjshme të ortakëve do të jenë më shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

## NENI 14 LENIA DHË TRASFERIMI I PJESËVË TË KAPITALIT

14.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërisë në përputhje me dispozitat e lëgjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

14.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjesëve të tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyrë:

---



- Oferta per shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;
  - Oferta duhet të përcaktojë numrin e kuotavë që shitën dhe çmimin e tyre;
- Nëse ortakët e shoqërisë brenda tre muajsh nga oferta më shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotavë të ofruara më çmimin e kërkuar, atëherë ata konsidërohet se lejojnë shit-blejsh tek të tretët.

14.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashëguëshëm në rrugë trashigimie. Bashkeshorti, paraardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushtevë që lejohen në ligj.

14.4 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen më akt noterial dhe të dëpozitohen në organin kompetent.

## **KAPITULLI V** **ORGANET DREJTUESE DHË ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

### NENI 15 ORGANET DREJTUESE

15.1 Organet drejtuesë të shoqërisë do të jenë asambleja e ortakëve dhe administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmën dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotëruar të kuotavë të kapitalit themeltar të shoqërisë do ti referohemi më termin Asamblë e Ortakëve.

15.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorin e shoqërisë "**Innovative Marketing Idea**" ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

15.3 Përveç organëve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organë të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.

15.4 Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pësë) vjeçare është emëruar Amir Memaj, i datëlindjes 26/06/1979 shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër, dhe banues po në Shkodër i cili identifikohet më kartë identiteti me numër personal H90626101R.


## **KAPITULLI VI** **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

### NENI 16 VENDIMET E ASAMBLESE TË ORTAKËVE

16.1 Asambleja e ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

16.2 Vendimet e zakonshme të asamblesë së ortakëve merren më votën e ortakëve

---



që zotërojnë më shumë së gjysmën e kuotavë të kapitalit themeltar, përveç rasteve kur ligji apo statuti kërkon një shumicë të ndryshme.

16.3 Paditë, që lidhën më shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhëniëve kontraktorë më shoqërinë, rregullohen sipas dispozitavë ligjore në fuqi.

#### NENI 17

#### KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKËVE

17.1 Në përputhje më dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi më shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakëve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje më këtë çështje.

17.2 Vendimet e marra në këtë mënyrë janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.

#### NENI 18

#### MËNYRA DHE VENDI I THIRRJËS SË ASAMBLËSË SË ORTAKËVË

18.1 Asambëja e ortakëve thirret pranë selisë së shoqërisë, apo në ndonjë vend tjetër brenda apo jashtë Shqipërisë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim që iu dërgohet ortakëve nga kryetari i asamblesë së ortakëve dhe/os organi administrativ në e-mail:

- “[mrmemaj@gmail.com](mailto:mrmemaj@gmail.com)” dhe në numër telefoni +355699681865.

18.2 Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë duhet të kryhet 15 (pësemëdhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të përcaktojë shprehimisht datën, orën, vendin si dhe rendin e ditës. Në rast pamundësië apo mosvëprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblesë së ortakëve mund të thirret nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo më shumë ortakë, të cilët përfaqësojnë jo më pak së 10% të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 19

#### KRYETARI I MBLEDHJES SË ASAMBLËSË SË ORTAKËVE

19.1 Mbledhja e asamblesë së ortakëve emëron kryetarin e asamblesë.

19.2 Kryetari i asamblesë vërfikon thirrjen dhe mbledhjen e rrëgullt të asamblesë së ortakëve, vërteton identitetin apo legjitimitimin e përfaqësuësit të ortakëve dhe drejton zhvillimin e rrëgullt të mbledhjes.

---



NENI 20  
PJESËMARRJA NË VENDIME

Çdo ortak ka të drejtën E një votë për cdo kuotë të kapitalit themeltar të shoqërisë që ai zotëron. Një ortak mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, nëpërmjet një akti përfaqësimi me shkrim.


NENI 21  
KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKËVË

21.1 Asambleja e ortakëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, kjo në varësi të çështjes për të cilën është thirrur. Vendimet e asamblesë së zakonshme të ortakëve merren vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë votë, që zotërojnë më shumë së 30% të kuotavë. Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve merren më një shumicë të cilësuar prej 3/4 të votavë të ortakëve të shoqërisë. Për çfarë nuk është pasqyruar në këtë nen, asambleja e ortakëve të shoqërisë vendos në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04. 2008, i ndryshuar.

21.2 Kompetencat e asamblesë së zakonshme të ortakëve do të jenë:

- Vendos për përpilimin ose miratimin e rregullorevë për shoqërinë apo për fusha te vecanta të veprimtarisë.
- Vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë.
- Vendos për krijimin e zyravë osë të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërivë osë të ortakërivë me persona të tjerë fizikë apo juridikë.
- Vendos për politikën afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emëron dhe shkarkon më një shumicë të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë : administratorin e shoqërisë, ekspertin kontabël, likuidatorin duke përcaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, të drejtat, detyrimet, kohëzgjatjen në detyrë, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos në lidhje më krijimin e organeve të tjera drejtuesë që mund ti nevojiten shoqërisë dukë përcaktuar në aktët e krijimit të këtyrë organëve, kohëzgjatjen dhe kompetencat e tyre, për emërimin e personavë drëjtuës të këtyrë organevë.
- Asambleja e ortakëve marrjen e vendimëve që kryen vetë dhe nuk bën delegimin e vendimarrjës të asnjë organ tjetër. Asambleja e ortakëve vëndos edhe në lidhje më krijimin e sëktorëve të vëçantë të vëprimtarisë së shoqërisë.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjëtor, përcakton llojin e fondëve të ndryshme dhe masën ëetyrë, përcaktimin e dividendit, marrjen dhe dhëniën e huavë, kredivë, borxhëvë.
- Realizon marrëdhëniët më të rëndësishmë ekonomikë dhe financiarë të shoqërisë me persona të tjerë fizik apo juridik, vendas apo të huaj.
- Miraton një tabelë për tarifat e shërbimëve të shoqërisë sipas fushavë
- Vendos në lidhje me transfëriminë pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë.

---



21.3 Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve janë:

- Vendos në lidhje me zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themëltar të shoqërisë.
- Vëndos në lidhje më kohëzgjatjen e shoqërisë si dhe për mbarimin e likuidimit të saj.
- Vendos për ndryshimin e emrit të shoqërisë.
- Vendos në lidhje më ndryshimin e statutit të shoqërisë.
- Vendos për ndryshimin e formës, për ndarjen e shoqërisë si dhe përbashkimin e saj më shoqëri të tjera.

21.4 Përveç kompetencave të lartpërmendura, të cilat janë ekskluzivë për të, asambleja e ortakëve ushtron çdo kompetencë që ia njeh ligji.

21.5 Asambleja e ortakëve në rastet kur nuk ka emëruar administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë statut janë përcaktuar për këtë të fundit. Gjithashtu, asambleja e ortakëve mund të kufizojë administratorin në ushtrimin e kompetencave të tij.

## NENI 22


### ADMINISTRATORI DHË KOMPETENCAT E TIJ

22.1 Kompetencat e administratorit ose të administratorëve, në mënyrë konkrete dhe të detajuara përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Vëç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.
- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet asamblesë së ortakëve për shqyrtim.
- Kordinon veprimtarinë e personave të punësuar në shoqëri.
- Ndjek problemet e shoqërisë në marrëdhënie më organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- I propozon asamblesë së ortakëve tarifat e shërbimeve dhe pagat për personelin e punësuar në shoqëri.
- I propozon asamblesë së ortakëve rregullorën e shoqërisë.
- Administratorët kanë të drejtë të gjithë sëbashku ose veçmas nga njëri tjetri të përfaqësojnë shoqërinë në lidhje më të tretët.

22.2 Administratori ose administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkëlqje ligjore, qoftë për shkëlqje të statutit ose për fajë të kryera gjatë ushtrimit të administrimit të shoqërisë. Përgjegjësia është individuale ose solidarë, kjo në varësi të rrethanave dhe të mënyrës sesi është vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

---



## **KAPITULLI VII**

### **LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDËNTËT, KONTROLLI KONTABËL**

#### **NENI 23 KONTROLLI KONTABËL**

Kontrolli i jashtëm kontabël i shoqërisë kryhët nga ekspertë kontabël të autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Asamblëja e ortakëve do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato rastë kur emërimi i tyre konsiderohët i nevojshëm osë kërkohët në bazë të ligjit.

#### **NENI 24 LIBRAT E SHOQËRISË**

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përvëç librit të shoqërisë, në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakëve dhe kapitali themëltar, si dhe vendimët e asamblësë së ortakëve, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.


#### **NENI 25 BILANCI DHË REZERVAT**

25.1 Bilanci mbyllët në 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetorë, inventari, raportet mbi operacionët e vitit financiarë dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, i paraqitën për shqyrtim asamblësë së ortakëve, ë cila vëndos mbi miratimin, ndryshimin osë rrezimin ë këtyrë aktëvë, kur ë konsidëron të nevojshëmë asamblëja ë ortakëve mund të bëjë rëkomandimët ë nevojshëmë në lidhjë më çështjënë diskutim.

25.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, administratori i vetëm merr masat e nevojshme për hartimin ë projekt-bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që asamblëja ë ortakëve të vëndosë mbi miratimin apo ndryshimët ë mundshëmë të tij brënda afatëvë të përcaktuara nga ligji.

25.3 Asamblëja e ortakëve vëndos mbi ndarjen ndërmjët ortakëve të shumavë që rëzultojnë si fitime sipas bilancit të aprovuar rrëgullisht, pasi nga këto shuma të jënë zbritur humbjët ë mundshëmë të vitëvë të mëparshëmë, si dhe të jënë lënë mënjane shumat ë nevojshëmë për krijiminë rëzërvës ligjorë. Rezerva ligjorë krijohët vit pas viti nëpërmjët lëniës mënjane të një shumë të barabartë më 5 % të fitimit nëto të realizuar gjatë sëcilit vit financiar, dëri sa të arrihet një shumë e barabartë më 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

---



25.4 Asambleja e ortakëve në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masën e tyre.

## **KAPITULLI VIII** **MBARIMI DHË LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

### NENI 26 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve ose kur ka një prisheë të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

### NENI 27 LIKUJDIMI

27.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja e ortakëve cakton një ose disa likujduës, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

27.2 Në fund të procesit të likujdimit, asambleja e ortakëve vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

27.3 Mbas pagimit të kreditorëve asambleja e ortakëve mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shpërndahet ortakëve.

## **KAPITULLI IX** **MOSMARRËVËSHJËT DHË DISPOZITA TË FUNDIT**

### NENI 28 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen së do ta zgjidhin më mirëkuptim, dhe në rast së kjo nuk arrihet gjykata kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konfliktëve të mundshme do të jëtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

---



NENI 29  
DISPOZITA TË FUNDIT

29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtarë si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.

29.2 Ky statut është hartuar në 2 (Dy) ekzemplare, në gjuhën shqipe , duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Ortaku i shoqerise**  
**Innovative Marketing Idea**  
**Shpk**

**Amir Memaj**



